



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1115/1 Prot.

Tiranë, më 01. 08. 2019

### V E N D I M

**Nr. 104, Datë 01. 08. 2019**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 82, datë 16.07.2019, e shtetasit E. M., kundër Emisionit Investigativ “STOP”, në Televizionin Klan, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të gjendjes shëndetësore*.

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesi shpjegon se në emisionin STOP të datës 00.00.2019, transmetuar në Televizionin Klan, është diskriminuar dhe fyer nga ana e dy drejtuesve të emisionit për shkak të gjendjes shëndetësore të kaluar. Sipas tij, referuar videos së emisionit, drejtuesit e emisionit duke mos pasur asnjë fakt e cilësojnë si “të sëmurë të shëndetit mendor”, madje moderatori S. K. flet me përcmim për të, përsa i takon gjendjes shëndetësore dhe shprehet me gjeste e me gjuhën e trupit, që ankuesi nuk duhet të qëndroj në atë pozicion pune. Sipas tij nga ana e drejtuesve të emisionit nuk është paraqitur asnjë fakt për të vërtetuar nëse ai ka patur probleme të shëndetit mendor apo jo dëmtime fizike të tjera.

Një moment tjetër ku ankuesi pretendon se është ndier i diskriminuar, është momenti kur moderatori G. Z., tallej hapur dhe në sfond dëgjoheshin të qeshura, kur tallej me faktin e “rënies së një tulle apo suvaje në kokë”. Sipas tij, e gjithë kjo situatë ka sjellë dëme duke i kujtuar edhe një herë aksidentin që ka pësuar kohë më parë, si për të dhe për familjarët e tij, ashtu dhe në prishjen e imazhit në punë.

Përveç këtyre, sipas ankuesit, emisioni STOP, në faqen zyrtare të tij në rrjetin social Facebook, ka publikuar videon e emisionit të datës 00.00.2019, duke mos marrë asnjë masë për administrimin e kësaj faqeje online, ankuesi është fyer, në nderin dhe dinjitetin tij dhe të familjes.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- të konstatohet diskriminimi i drejtëpërdrejtë për prishjen e imazhit dhe figurës në publik,
- përgenjshtrimin e rastit si të pavërtetë,
- rekomandimin për të hequr nga faqja online në rrjetin social Facebook publikimet e bëra, që mbartin opinione denigruese.
- marrjen e masave administrative ndaj emisionit STOP, dhe rekomandim për mospërsëritjen e këtyre publikimeve diskriminuese.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstronhet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”*. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, në nenin 3, pika 1, sanksionon: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Në kuadër të ushtrimit të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar edhe raste të tjera të gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj individëve apo një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike.

Përsa më lart dhe mbështetur në parashtrimet e bëra në ankesë, ankuesi ka ngritur pretendimin se subjekti ndaj të cilit ka paraqitur ankesën, ka përdorur shprehje fyese apo denigruese ndaj tij, duke e vënë në pozita diskriminuese. Në këtë kuptim dhe referuar videos<sup>1</sup>, së analizuar gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, të emisionit STOP të datës 00.00.2019, nga Komisioneri u evidentua se moderatorët e emisionit ndër të tjera kanë kërkuar nga organet përkatëse, të analizojnë rastin apo incidentin që ka ndodhur ndërmjet ankuesit dhe një ish punonjësi tjetër policie, për t’i dhënë një zgjidhje situatës së denoncuar nga shtetsi A. H. Gjatë të gjithë emisionit

<sup>1</sup> <https://www.youtube.com>

nga ana e moderatorëve dhe denoncuesit, janë nxjerrë të dhëna lidhur me gjendjen shëndetësore që ka ose mund të ketë patur ankuesi, por evidentohet se nuk është përdorur terminologji apo shprehje fyese apo denigruese të cilat nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen.

Referuar më sipër, E. M. nuk ka vënë në dispozicion asnjë informacion, provë apo indicie, me anë të së cilës të argumentojë trajtimin në mënyrë më pak të favorshme apo diskriminues nga ana e moderatorëve të emisionit STOP. Pra, E. M. nuk ka paraqitur asnjë informacion apo argument që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të krijojë në pamje të parë bindjen e trajtimit të tij në mënyrë më pak të favorshme për një nga shkaqet e parashikuara në Ligjin nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Përsa i përket shkakut të diskriminimit të pretenduar, ankuesi citon në ankesë se: *“është diskriminuar dhe fyer nga ana e dy drejtuesve të emisionit për shkak të gjendjes shëndetësore të kaluar”*. Pra, referuar dokumentacionit dhe argumentave të vëna në dispozicion nga ankuesi, ai nuk pranon faktin që aktualisht apo në të shkuarën ka patur probleme të shëndetit mendor, çka hedh poshtë pretendimin se situata diskriminuese i ka ardhur për shkak të gjendjes shëndetësore. Në këtë kuptim, nga ana e ankuesit është paraqitur informacion mbi problematikën që ka, lidhur me publikimin e një informacioni të cilin e konsideron të pavërtetë, por nuk ka paraqitur fakte, prova apo shpjegime për të argumentuar shkakun e pretenduar të diskriminimit dhe për të provuar se trajtimi i pabarabartë i tij është bërë për këtë shkak.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se nga ana e emisionit STOP janë transmetuar apo publikuar informacione të pavërteta kundrejtë tij, duke e fyer apo cënuar dinjitetin, referuar nenit<sup>2</sup> 119 dhe 120 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, ankuesi ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatën kompetente për veprat penale të fyerjes apo shpifjes.

Ligji nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, në nenin 33, pika 4/ç të tij, parashikon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*.

---

<sup>2</sup> Neni 119 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.”*

Neni 120 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.”*

Në përfundim, duke analizuar në tërësi ankesën Nr. 82, datë 16.07.2019, të E. M., Komisioneri gjykon se, në rastin konkret në mungesë të informacionit të mjaftueshëm për shqyrtimin e saj, ankesa nuk mund të pranohet dhe t'i nënshtrohet procedurave të hetimit administrativ.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit E. M., për shkak se është haptazi e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**

**Në mungesë dhe me porosi,**

**Ardiana HALA**

**DREJTORE**

(Shkaku: Gjendja shëndetësore)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)